

VENDIM
Nr. 30, datë 3.2.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“DELIU 3D” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 186/1 prot., datë 30.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Deliu 3D’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Deliu 3D” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 186 prot., datë 17.1.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shiroku”, me kapacitet të instaluar 1.600 MW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Holtës dhe përroit të Hotomizës me derdhje në përroin e Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germen “c”; si dhe për pikën 2.1 gerrat “a”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Deliu 3D” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kontratën nr. 1894 rep., nr. 1092/3 kol., datë 29.8.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e Hidrocentralit ‘Shiroku’ me kapacitet prodhues 1.600 mw, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Holtës dhe të përroit të Hotomizës me derdhje në përroin e Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”;

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së OSSH sh.a. nr. 13114/3 prot., datë 15.1.2025;

- Ka depozituar në ERE vendim nr. 17, datë 8.5.2023, “Për miratimin e lejes ‘Për përdorim të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë ‘Deliu 3D’ sh.p.k.’”, të Këshillit të Basenit Ujqor Seman, si dhe lejen për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor nr. 450 prot., datë 11.5.2023, e lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujqor (KBU) Seman. Vlefshmëria e kësaj lejeje është 5 vjet.

- Ka depozituar vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 7.6.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i HEC Shiroku”, me fuqi të instaluar 1600 kW, nga shoqëria “Deliu 3D” sh.p.k.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka dorëzuar dokumentet e mëposhtme në format fotokopje apo në format elektronik. Në përputhje me përcaktimet e nenit 8, pika 3, të rregullores, shoqëria duhet të dorëzojë në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin si më poshtë:

- kontratën nr. 1894 rep., nr. 1092/3 kol., datë 29.8.2018, të nënshkruar me MIE-n, si dhe kontratën shtesë nr. 722 rep., nr. 199 kol., datë 19.4.2024, e cila nuk rezulton të jetë depozituar;

- kontratën e kredisë bankare afatgjatë;
- vendimin nr. 17, datë 8.5.2023, të KBU-së Seman dhe lejen për përdorimin e burimit ujq sipërfaqësor;
- shkresën e OSSH sh.a. “Miratim pikë lidhje për HEC Shiroku”.
- Po ashtu nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin që tregon se nuk ka detyrime të pashlyera në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke u referuar periudhës së aplikimit në ERE. Vërtetimet dhe deklaratat duhet të jenë lëshuar jo më parë se 1 (një) muaj nga momenti i paraqitjes së aplikimit.

- **germa “b”:** Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE aftësinë financiare për realizmin e investimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se shoqëria ka marrë kredi nga banka në një vlerë më të vogël se sa ishte parashikuar në planin e biznesit, rreth 40%, krahasuar me 80% që kishte planifikuar. Po ashtu, shoqëria nuk ka bërë me dije mbi burimet e tjera të financimit dhe dokumentacionin në të cilin mbështet financimin e investimit.

- Po ashtu, në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake (e vlefshme deri më 7.6.2026) dhe duke qenë se në shtojcën 2 shoqëria ka deklaruar se viti i ndërtimit të hidrocentralit është 2024–2025, por shoqëria nuk ka informuar nëse punimet për ndërtimin e tij kanë filluar, vlerësohet t’i kërkohej ky informacion në vijim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Deliu 3D” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shiroku”, me kapacitet të instaluar 1.600 mw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Holtës dhe përroit të Hotomizës me derdhje në përroin e Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Deliu 3D” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti